

NË ËMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari njëherit edhe kryetar i trupit gjykues, Xheladin Osmani, me sekretaren juridike Zeqije Grazhda, në qeshtjen penale kunder të akuzuarit G. P., nga nga fshati F., rrethi I L., R. e Shqipërisë, për shkak të veprës penale dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KP, duke vendosur sipas aktakuzes së dhe marrveshtjes për pçranimin e fajsisë të Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/I nr.86/2018, të dt.24.07.2018, në shqyrtimin e marrveshtjes për pranimin e fajsisë të mbajtur më dt.27.07.2018, në prezencen e prokurorit të shtetit Genc Nixha, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, B. B., avokate nga Prizreni, po të njejten ditë muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G. P., nga i ati Ll. dhe ëma Xh., me mbiemër të vajzërisë N., i lindur më dt. *data e lindjes...*, në fshatin K., tani me banim në fshatin F., rrethi i L., shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, ka të kryer shkollën fillore, vozites, beqar, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Më datë 20.07.2018, rreth orës 15:00, në piken kufitare të Vermicës, në hyrje nga Shqipëria për në Kosovë, është vertetur se në mënyrë të drejtpërdrejtë ofron personit zyrtar përfitim pasuror, në mënyrë që i njejti të veproj ose mos të veproj në pajtim me detyren e tij zyrtare, në atë mënyrë që gjatë kalimit të pikes doganore, duke drejtuar automjetin për transport-Marimangë, e markës “Mercedes-Benz”, me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, me kerkesën e policit për kontrollimin e dokumentit, në dokumentin e dorëzuar-certifikaten e regjistrimit të automjetit, ka futur shumen prej 5 (pesë) euro, të cilën më pas e ka vrejtur polici dhe në pyetjen e tij se për qka janë këto të holla, i njejti nuk është përgjigjur me çrast paratë e dorëzuara janë ndalë nga ana e zyrtarit policor.

Këso dore ka kryer veprën penale dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KP.

PRANOHET marrveshtja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorit të Shtetit pranë Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda dhe të akuzuarit G. P., me praninë e mbrojtësin e tij av.B. B., PP/I nr.86/2018, e dt.24.07.2018, për shkak të veprës penale dhënja e ryshfetit, nga neni 429 par.1 të KP, i akuzuar sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I nr.86/18, të dt.24.07.2018.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 3, par.1,7,8,9,10,42 par1 pika 1, 43 par.1.3, 46, 73, 74 dhe 75, të akuzuarin G. P. e

G J Y K O N

Me denim me gjobë në shumen prej 300 (treqindë) euro, denim të cilin është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari denimin prej 300 (treqindë) euro, nuk dëshironë apo nuk mundet ta paguaj, gjykata për çdo 20 euro nga shuma e dënimit do tu caktojë një ditë burgim.

Obligohen të akuzuarit, të paguajnë paushallin gjyqësor secili me nga 50 euro, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e formës së prerë të aktgjykimit.

Në bazë të Qarkorës së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjuit nr.05/L-36, për kompenzimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018, obligohet i pandehuri E. M. që konform nenit 39 të Ligjit të lartcekur të paguaj shume prej 50 euro në Fondin për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë, PP/I nr.86/2018 të dt.24.07.2018, kundër të pandehurit G. P. nga fshati F., rrethi i L., Republika e Shqipërisë, për shkak të vepres penale dhënja e ryshfetit nga neni 429 par.1 të K-së.

Më datën 24.07.2018, i pandehuri me mbrojtësen e tij, av. B. B., kanë hyrë në negociata për marrveshrtjen për pranimin e fajsisë, marrveshje e cila edhe është lidhur në praninë e të pandehurit, mbrojtësit, prokurorit të shtetit dhe e nenshkruar nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren.

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për krime të rënda, gjykates gjithashtu ia ka parashtruar marrveshrtjen për pranimin e fajsisë, PP/I nr.86/2018 të dt.24.07.2017, marrveshje kjo e lidhur në Prokurorin Themelore në Prizren, në mes të prokurorit të shtetit Genc Nixha, të akuzuarit G. P. më pjesmarrjen e vokats B. B. dhe e nenshkruar nga kryeprokurori i PTH në Prizren.

Aktakuzën dhe marrveshrtjen në shqyrtim, e ka perfaqësuar prokurori i shtetit G. N., i cili ka lexuar aktakuzën PP/I nr.86/18 të dt.24.07.2018 dhe shkurtimisht ka elaboruar marëveshjen për pranimin e fajsisë, ka ngelur në tërësi pranë marëveshjes dhe aktakuzës dhe ka propozuar që gjykata ta pranojë këtë marëveshje.

Gjykata në këtë shqyrtim, gjithashtu ka mbajtur seancën lidhur me pranimin e marëveshjes mbi pranimin e fajsisë, konformë nenit 233 ka vlersuar marrveshrtjen mbi pranimin e fajsisë, ka degjuar prokuroren e shtetit e cili ka përfaqësuar aktakuzën dhe marëveshjen mbi pranimin e fajsisë, të akuzuarit G. P. në prezencën e mbrojtësit –avokates B. B., ka vlerësue se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga e tij pas konsultimeve me mbrojtësin, ka vlersuar se nuk ka qenë i detyruar ose i shtrenguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë.

I akuzuari G. P., pas konsultimeve me mbrojtësin e tij dhe pas udhëzimit nga na e kryetarit të trupit gjykues ka pranuar në tërësi fajsinë për vepren penale dhënja ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215 par.2 të KP.

Kryetari i trupit gjykues vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çeshtjës që përmban aktakuza, nga materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çart ligjore ose gabime faktike, i akuzuari e pranoi fajsinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe atë pas marrjes së mendimit të prokurorit, dhe vet të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij, mori vendimin mbi pranimin e fajsisë e pastaj është vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me vet pranimin nga ana e të akuzuari G. P. dhe nga shkresat e lëndës, është vërtetuar në tërësi pretendimi i Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për krime të paraqitur në dispozitivin e aktakuës.

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e PTH-it në Prizren, e poashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale që i vëhet në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se i akuzuari në aspektin penal- juridik është përgjegjës për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas marrveshtjes prokurori i shtetit ka propozuar që të akuzuarit G. P. ti shqiptohet denimi me gjobë, në shumën prej 300 (treqindë) euro.

Gjithashtu gjykata ka vlerësuar se pranimi mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë dhe në provat materiale të paraqitura nga prokurori të pranuar nga i pandehuri si dhe me deshmët tjera të paraqitura nga prokurori.

Gjykata është bindur se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18 të nenit 233 të këtij kodi, ka pranuar marrveshtjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të ndëgjimit në seancë ka shqiptuar edhe denimin sipas marrveshtjes e i përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata, gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, për të akuzuarin G. P. në kuptim të nenit 73 dhe 75 të KP, pati parasyshë të gjitha rrethanat që ndikojnë në zgjedhjen e llojit të lartësisë së dënimit, duke e gjetur si rrethanë rënduese rrezikun shoqëror, shkallën e rrezikut të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, pranimin e fajësisë, dhe lidhja e marrveshtjes për të akuzuarin, është i gjendjes se varfër ekonomike dhe gjerë më tani të padënuar, për këtë gjykata edhe pranoj marrveshjen e lartëcekur, e bindur se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2.6 të KPP-së

Vendimin mbi kompenzimin e viktimave të krimit u muar në bazë të Qarkorës së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjuit nr.05/L-36, për kompenzimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
PKR.nr.56/2018, me date:27.07.2018

Sekretarja juridike,
 Zeqije Grazhda

Kryetari i trupit gjykues,
 Xheladin Osmani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afatë prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e neprimjet të kësaj gjykate.